

**KONTRATE THEMELIMI  
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" ADA KONSTRUKSION " SH.P.K.**

**Personat qe firmosin me poshte:**

**Julien ROCHE**, i biri i Mariusit, me shtetesi franceze, i datelindjes 1954, banues ne Vila Nr. 11, Plazh, Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 91AE75972;

**Marsel SKENDO**, i biri i Zagollit, i datelindjes 1949, banues ne Tirane Rr. " Dervish Hima ", Ada Tower, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 0165026

dhe

**Faruk KABA**, i biri i Jusufit, i datelindjes 1945, banues ne Tirane Rr. "Komuna e Parisit", Pall. "Ndertim Vila", P.4, Ap.18, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 0550775;

kane hartuar, si me poshte vijon, kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre.

Shoqeria vepron ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi si dhe dispozitave te statutit qe i bashkengjitet ketij akti.

Emertimi i shoqerise eshte " ADA KONSTRUKSION " SH.P.K.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte: Punime dherash, murature, betoni dhe beton-  
armeje, ndertime civile dhe industriale, te infrastruktures, rruge, autostrada, ura betoni dhe  
metalike, tunele, ndertime te telekomunikacionit, te energjise, ndertime turizmi dhe te  
bujqesise, ndertime mbitokesore e nentokesore, prodhim e tregetim me shumice e me pakice  
i materialeve te ndertimit, import dhe eksport i tyre. Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu  
veprimtari te tjera si import - eksport mallrash e paisjesh, sipermarrje te ndryshme, etj., ne  
perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe te konsideruara nga shoqeria me perfitim  
dhe te dobishme.

Selia e shoqerise ndodhet ne Rruga " Dervish Hima ", ADA TOWER, Tirane, Shqiperi.

Kohezgjatja e shoqerise eshte 10 vjet. Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te  
shkurtohet kur shoqeria priset parakohe.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000 lek, i ndare ne 400 pjese prej 1.000 lek secila.  
Ky kapital perbehet nga kontributet e meposhteme ne para:

Z. Julien ROCHE kontribuon me shumen prej 180.000 lek dhe zoteron 180 pjese;



Z. Marsel SKENDO kontribuon me shumen prej 180.000 lek dhe zoteron 180 pjese;  
Z. Faruk KABA kontribuon me shumen prej 40.000 lek dhe zoteron 40 pjese.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar, shlyer plotesisht dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me lart.

Sejcili prej ortakeve te ardhshem ka derdhur tek Z. Faruk KABA shumen korresponduese te pjeseve te nenshkruara. Shumat e mbledhura jane depozituar prej tij ne Banken \_\_\_\_\_, Tirane, ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper.

Shumat e depozituar vertetohen me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo Banke, ne te cilen shenohen emrat dhe mbiemrat e ortakeve te ardhshem, pjeset e kapitalit themeltar te nenshkruara dhe shuma e derdhur nga sejcili prej tyre.

Personat qe firmosin kete kontrate, pasi kane marre dijeni per kete certifikate, nje kopje e sakte e te ciles u eshte paraqitur atyre, deklarojne se shumat e derdhura prej tyre jane ne perputhje me ate qe shenohet ne certifikate dhe se ata konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumat respektive te derdhura.

Ne kohen e themelimit shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem. Administratori i pare i emeruar eshte Z. Faruk KABA, me nje mandat 3 vjeçar dhe me te drejte rizgjedhje.

Z. Faruk KABA i jepen te gjitha kopetencat, te cilat ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Ai gjithashtu eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj ne gjykate, veçanerisht ai eshte i pajisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te shoqerise, te cilat i kalojne shoqerise nga momenti i regjistrimit.

Pervec te tjerave, administratori eshte i ngarkuar per te kryer akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kopetencat e tij. Pasi te behet regjistrimi i shoqerise, keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve, jo me vone se sa nga data e mbledhjes se Asamblese qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit te pare financiar. Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.


Kjo kontrate themelimi eshte hartuar ne Tirane me \_\_\_\_\_ ne 4 ekzemplare origjinale.

#### ORTAKET

Julien ROCHE



Marsel SKENDO



Faruk KABA





**STATUT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" ADA KONSTRUKSION " SH.P.K.**

**Personat qe firmosin me poshte:**

**Julien ROCHE**, i biri i Mariusit, me shtetesi franceze, i datelindjes 1954, banues ne Vila Nr. 11, Plazh, Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 91AE75972;

**Marsel SKENDO**, i biri i Zagollit, i datelindjes 1949, banues ne Tirane Rr. " Dervish Hima ", Ada Tower, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 0165026

**dhe**

**Faruk KABA**, i biri i Jusufit, i datelindjes 1945, banues ne Tirane Rr. "Komuna e Parisit", Pall. "Ndertim Vila", P.4, Ap.18, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 0550775;

kane hartuar, si me poshte vijon, statutin e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ADA KONSTRUKSION " SH.P.K., te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre.

**Neni 1  
Forma**

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me dispozitat e ketij statuti.

**Neni 2  
Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte " ADA KONSTRUKSION " SH.P.K.

**Neni 3  
Objekti i shoqerise**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

Punime dherash, murature, betoni dhe beton-armeje, ndertime civile dhe industriale, te infrastruktures, ruge, autostrada, ura betoni dhe metalike, tunele, ndertime te telekomunikacionit, te energjise, ndertime turizmi dhe te bujqesise, ndertime mbitokesore e nentokesore, prodhim e tregetim me shumice e me pakice i materialeve te ndertimit, import dhe eksport i tyre.



Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu aktivitetete te tjera si import – eksport mallrash e paisjesh, sipermarrje te ndryshme, etj., ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe te konsideruara nga shoqeria me perfitim dhe te dobishme.

**Neni 4**  
**Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise ndodhet ne Rruga “ Dervish Hima “, ADA TOWER, Tirane, Shqiperi.

**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte 10 vjet. Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur shoqeria prishet parakohe.

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar eshte ne para, ne vleren 400.000 leke, i ndare ne 400 pjese me vlere 1.000 leke secila.

- Z. Julien ROCHE zoteron 45 % te pjeseve te Kapitalit Themeltar, ose 180 pjese me vlere 180.000 leke.
- Z. Marsel SKENDO zoteron 45 % te pjeseve te Kapitalit Themeltar, ose 180 pjese me vlere 180.000 leke.
- Z. Faruk KABA zoteron 10 % te pjeseve te Kapitalit Themeltar, ose 40 pjese me vlere 40.000 leke.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja , ortaket kane te drejten e perparise ne nenshkrim, proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre, por ata jane te lire te heqin dore nga kjo e drejte.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e ortakeve me shumicen e ortakeve te pranishem ose te perfaqsuar, qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar. Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithë ortaket ne te njejten mase.

**Neni 7**  
**Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, me rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve, dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten mark]*



Pjeset e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve dhe me kushte jo me te favoreshme se ato me te cilat ju jane ofruar me pare ortakeve te tjere.

### **Neni 8 Ortaket dhe asamblea e ortakeve**

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Ne ushtrimin e te drejtes se tyre per te marre pjese ne vendimet kolektive, cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjetër, nga bashkeshorti ose nga nje person tjetër i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar, po qe se ka te tille ose nga likujduesit.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asamblea e zakonshme vendos per çeshtje te tilla si, emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimit, etj. Asamblea e jashtezakonshme vendos per çeshtje te tilla si ndryshimet e statutit, zvogelimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likujdimi i saj, shnderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera etj.

Asamblea e zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar dhe vendimet merren me shumice votash te mbi 1/2 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar. Ne qofte se mbledhja e pare e Asamblese se zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dyte e cila mund te marre vendime te vlefshme, pavaresisht se sa pjese te kapitalit themeltar zoterojne ortaket e pranishem ose te perfaqesuar dhe vendimet merren me nje shumice votash te mbi 1/2 te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Asamblea e jashtezakonshme kerkon kushte prezence ose perfaqesimi te njejta me ato te Asamblese se zakonshme si ne mbledhjen e pare ashtu dhe ne mbledhjen e dyte, por ajo merr vendime me shumice votash mbi 3/4 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

### **Neni 9 Administrimi**

Shoqeria administrohet nga nje administrator qe duhet te jete person fizik dhe mund te jete ortak ne shoqeri ose jo. Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e shumices



se ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar. Ekspertin i tij behet per nje kohezgjatje prej 3 vjetesh financiare me te drejte rizgjedhje, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne marredhenie me ortaket dhe te tretet administratori ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe statuti ja japin shprehimisht ortakeve. Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Administratori i emeruar ne kohen e nenshkrimt te ketij Statuti eshte Z. Faruk KABA.

#### **Neni 10 Ekspertet kontabel te autorizuar**

Ne rast nevojje ose ne se e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

#### **Neni 11 Viti financiar, llogarite vjetore, dividendet**

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te perfundoje me 31 dhjetor 2001.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asamblea me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar, brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asamblea e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin. Fitimi, qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te çdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetere i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme.

#### **Neni 12 Zgjatja e afatit, Prishja, Likuidimi, Shnderrimi i Shoqerise ne forma te tjera**

Zgjatja e Afatit mbas kohes se percaktuar ne Nenin 5, Prishja e Shoqerise me perfundimin e Afatit ose para kohe, Likuidimi i Shoqerise ose Shnderrimi i Shoqerise ne



forma te tjera kryhen per arsyet dhe sipas procedurave te parashikuara me ligj, mbas vendimeve perkatese te Asamblese se Jashtezakoneshme te Ortakeve.

**Neni 13**  
**Mosmarveshjet**

Ortaket do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarveshjet, qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit te saj. Ne rast deshtimi, mosmarveshjet do t'i paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente.

**Neni 14**

Ky statut eshte hartuar me dt. 11 Tetor 2001 ne Tirane, ne 4 ekzemplare origjinale.

**ORTAKET**

**Julien ROCHE**

**Marsel SKENDO**

**Faruk KABA**